



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 86, dt. 01.06.2015

Në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 01.06.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit të zbatimit të Hec “Gavran dhe Gavran 1”, në përroin e Fragovishtës, Komuna Stravaj, rrethi Librazhd.
2. Ngarkohet shoqëria të kontribuojë për restaurimin e “Kompleksi i shtatë çezmave të Moisi Golemit”, në fshatin Berzeshtë, Librazhd, sipas projekt-preventivit të hartuar nga DRKK-ja Durrës.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore punimet të mbikqyren nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI